



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Interlab" Sh.P.K. të datës 12.03.2024 kundër njoftimit për kontratë të datës 21.02.2023 dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për nevojat e KPSH" me nr. të prokurimit 616-24-1297-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Interlab" Sh.P.K. e datës 12.03.2024 kundër njoftimit për kontratë të datës 21.02.2023 dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për nevojat e KPSH" me nr. të prokurimit 616-24-1297-1-1-1.**
- II. LEJOHET autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.**
- III. NJOFTOHET grupi i operatorëve ekonomik "Interlab" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Operatori ekonomik "Interlab" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 12.03.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 21.02.2024 dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për nevojat e KPSH" me nr. të prokurimit 616-24-1297-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “Ne Dosjen e Tenderit, me konkretisht tek Pershtatshmeria profesionale nga Autoriteti Kontraktues është kërkuar që Operatori Ekonomik të ofrojë ISO 13485 2016, të cilën certifikate e posedojnë vetëm kompanitë prodhuese për pasije dhe produkte medicinale. Kështu Autoriteti Kontraktues ka vendosur një kriteri plotësisht të paqarte, i cili është njëkohësisht diskriminues dhe pamundëson konkurimin e mirefillte. Pos të tjerash, për realizimin e projektit është kërkuar që Operatori Ekonomik të posedojë së paku dy automjete (pikap-KOMBI) për bartjen e mallit dhe një Kamion 7.5T me rampa. Një specifikim i tillë është absurd dhe i pa baze me faktin që të gjitha produktet të parapara për furnizim janë barna dhe shpenzues tjerë mjekësorë që peshojnë shumë pak. Duke e ditur që kjo kontratë është e përcaktuar si kontratë me poentim dhe realizimi është 36 muaj me furnizim pjese-pjese, e ben edhe me të pakuptim kërkesën për të poseduar një automjetë me specifika të tilla (Kamion 7.5T) dhe mbi të gjitha specifikimin e peshës bartese”.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësi kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore.

Rrjedhimisht njësi kërkuese ka dërguar përgjigjen sipas së cilës kërkesat e kontestuara të dosjes së tenderit janë në përputhje të plotë me nevojat e njësisë kërkuese, qëllimin e kontratës dhe mbi të gjitha janë në përputhje të plotë me nenet 1, 6, 7, 28, 29, et. al të LPP.

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij akti vendimi.

Prishtinë, 18.03.2024



Ud. Udheheqës i Sektorit të Prokurimit
Komanda e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.